

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-108/13

**Prishtinë,
23 prill 2014**

Në çështjen juridike të:

A.J

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër.

M.M

Odës E.

Palët përgjegjëse në kërkesë/ Palët përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Erdogan HAXhineqiri, gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/184/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA11140), të datës 14 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 23 prill 2014, mori këtë:

AKTVENDIM

1. **Pranohet ankesa e A.J.**
2. **Lënda i kthehet KKPK-së për gjykim mbi kërkesën për ri-posedim (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA11140).**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 2 tetor 2007, pala ankuuese, ish paraqitësi i kërkesës, A.J, ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e një prone komerciale prej 100 metrave katrorë në rrugën "Vidovdanska" 20 në Prishtinë. Ai gjithashtu ka kërkuar kompensim për mos-shfrytëzimin e pronës së tij dhe ka kërkuar që të kompensohet për inventarin e shkatërruar.
2. Ai ka paraqitur një kontratë të lidhur në dhjetor 1996 me Odën E. të Kosovës dhe Metohisë. Lënda e kontratës ishte dhënia me qira e pronës së kontestuar nga Oda E. atij për ushtrimin e biznesit hotelier. Kontrata ishte për periudhë 5 vjeçare, duke filluar nga 1 dhjetori 1997 deri në vitin 2001 (neni 3 i kontratës). Kontrata më pas është ndryshuar dhe është shndërruar në një kontratë me afat të pacaktuar.
3. Ai ka paraqitur dokumente të tjera të shumta që lidhen me shfrytëzimin e lokalit pas vitit 1997: p.sh. një certifikatë mbi higjienën e ushqimit nga kontrollit sanitar, kontratën për ngrohjen e vendit etj.
4. Nuk është kontestuese se paraqitësi i kërkesës i ka shfrytëzuar lokalet nga viti 1998 deri 1999 kur atij i është dashur të largohet nga Kosova për shkak të konfliktit të armatosur.
5. Është bërë njoftimi i lokalit ë fjalë dhe M.M u përgjigj në kërkesë. Ai ka shpjeguar se një person i tretë e kishte lejuar atë që të shfrytëzoj pronën. Nga dokumentet në dosje të lëndës nënkuptohet se M.M pretendon se i është dhënë e drejta për shfrytëzimin e pronës nga Oda E. e Kosovës.
6. Pala e dytë përgjegjëse në kërkesë ishte përfshirë në procedurë - Oda E. e Kosovës. Në anën tjetër Oda E. konteston të drejtën e M.M për të shfrytëzuar pronën.
7. Çfarëdo mosmarrëveshje që mund të ketë në mes të M.M dhe Odës E. të Kosovës ato janë të parëndësishme në këtë rast, sepse çështja aktuale ka të bëjë me të drejtën e pretenduar të kërkuar nga paraqitësi i kërkesës A.J e jo me mosmarrëveshjet në mes të M.M dhe Odës E. të Kosovës .

8. Në një kohë të caktuar të procedurës pranë KKPK-së, Sekretaria Ekzekutive ka konsideruar se paditësi e ka ndryshuar kërkesën e tij dhe nuk është duke kërkuar më ri-posedim, por vetëm kompensim. Sipas raportit të Sekretarisë, ata kanë kontaktuar palën përgjegjëse në kërkesë dhe në bisedë telefonike ai ka deklaruar se ai vetëm kërkon kompensim monetar.
9. KKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën për kompensim pasi që ajo nuk është në juridiksion të Komisionit.
10. KKPK-ja nuk ka marrë vendim në lidhje me kërkesën për ri-posedim, pasi që ajo ka konsideruar se kërkesa është tërhequr.
11. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 27 mars 2013. Ai ka paraqitur ankesë në të njëjtën ditë.
12. Pala përgjegjëse në kërkesë/tani pala përgjegjëse në ankesë nuk është përgjigjur në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese:

13. Pala ankuese pohon se ai nuk e ka tërhequr kërkesën e tij për ri-posedim. Ai kërkoi nga AKP-ja që t'i paraqes atij prova se ai e ka bërë këtë. Më pas dikush nga Agjencia e thirri atë dhe konfirmoi se nuk kishte asnjë kërkesë me shkrim për tërheqjen e kërkesës së tij për ri-posedim.

Pranueshmëria e ankesës:

14. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur në të njëjtën ditë kur vendimi i është dërguar parashtruesit të kërkesës, tani palës ankuese.
15. Përderisa aktgjykimi i KKPK-së kundërshtohet vetëm për arsye se KKPK-ja nuk ka vendosur rreth kërkesës për ri-posedim, ankesa duhet të konsiderohet si një kërkesë për marrjen e aktgjykimit plotësues - argumentin sipas nenit 164.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të vitit 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), që zbatohet *mutatis mutandis* në procedurën pranë Gjykatës Supreme duke iu referuar nenit 12.2 të UNMIK/REG/2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 të vitit 2008 (në tekstin e mëtejme Ligji 03/L-079).
16. Është e vërtetë se vendimi i KKPK-së është marrë vetëm në lidhje me kërkesën për kompensim. Nuk është vendosur lidhur me kërkesën për ri-posedim. Përveç kësaj, nuk ka të dhëna në dosje të lëndës se paraqitësi i kërkesës e ka tërhequr këtë kërkesë.

17. Ligji 03/L-079 nuk shpjegon se cila është forma e duhur e një tërheqje, ai përcakton në mënyrë të qartë vetëm një formë të veçantë me shkrim të kërkesës – paragrafi 2 i Aneksit II të Urdhëresës së UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin 03 / L - 079.
18. Megjithatë Ligji për Procedurën Administrative (Ligji nr. 02/L-28), që zbatohet *mutatis mutandis* para KKPK-së sipas kërkesës së nenit 11.1 të Ligjit 03/L-079, në nenin 51.1 parashihet që tërheqja e kërkesës për fillimin e një procedure administrative duhet të bëhet nëpërmjet një deklaratë me shkrim.
19. Edhe pa këtë dispozitë një tërheqje nga kërkesa pasurore juridike sipas Ligjit 03/L-079 nuk mund të pranohet që të jetë bërë në mënyrë të vlefshme në qoftë se nuk bëhet me shkrim. Nëse Ligji (paragrafi 2 i Aneksit II të Urdhëresës së UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079) parashihet një formë me shkrim të vet kërkesës edhe tërheqja duhet të bëhet me shkrim (argumenti sipas analogjisë), përveç nëse parashihet ndryshe, gjë që në këtë rast nuk ka ndodhur.
20. Prandaj ankesa/kërkesa për plotësimin e vendimit të KKPK-së, së bashku me vendimin dhe dosjen e lëndës duhet të dërgohen në shkallën e parë, që është KKPK-ja, për shqyrtim të kërkesës për ri-posedim.
21. Në bazë të të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit 03/L-79 dhe nenit 164.3 të LPK, Gjykata vendosi si në dispozitiv.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it